



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2666/ 4 prot

Datë 15.12.2022

V E N D I M
Nr. 1257/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.12.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Farma Net Albania*” SHPK në lidhje me shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertave të paraqitur nga operatorët ekonomikë “*Aquaris Medical*” SHPK dhe “*CFO Pharma*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF- 46319-10-18-2022, me objekt Loti 2 “*Blerje materiale mjekimi për qendrat shëndetësore që mbulojnë me shërbim zonat turistike verore gjatë sezonit të verës dhe qendrat shëndetësore që bllokohen gjatë sezonit të dimrit, për një periudhë 12 mujore*”, me fond limit 10,062,292 (dhjetë milion e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03-11-2022 nga autoriteti kontraktor Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shendetësor.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*Farma Net Albania*” SHPK
Adresa: Rruga “Siri Kodra” Nr. 8/660, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shendetësor.
Adresa: Rruga “Dibrës” Nr. 12, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.10.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-46319-10-18-2022, me objekt Loti 2 “Blerje materiale mjekimi për qendrat shëndetësore që mbulojnë me shërbim zonat turistike verore gjatë sezonit të verës dhe qendrat shëndetësore që bllokohen gjatë sezonit të dimrit, për një periudhë 12 mujore”, me fond limit 10,062,292 (dhjetë milion e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03-11-2022 nga autoriteti kontraktor Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shendetësor.

II.2. Në datën 03.11.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 17.11.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht::

- “Aquarius Medical” SHPK	8,489,898 lekë	I kualifikuar
- “Egian Med” SHPK	8,698,994 lekë	I skualifikuar
- “CFO Pharma” SHPK	8,888,888 lekë	I kualifikuar
- “Farma Net Albania” SHPK	9,335,560 lekë	I kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se autoriteti kontraktor më datë 23.11.2022 ka publikuar Njoftim-Fituesin për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 30.11.2022 operatori ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, ka paraqitur ankesë njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me objekt kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “Egian Med” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2666/2 prot datë 01.12.2022 referuar kritereve të cilat operatori ekonomik ankimues “Farma Net Albania” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurë “Aquarius Medical” SHPK, “CFO Pharma” SHPK dhe “Egian Med” SHPK.

II.7. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 3095/32 prot, datë 06.12.2022, protokolluar me tonën me nr. 2666/3 prot datë 07.12.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës si më poshtë vijon:

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK në ankesën e tij, bazuar në arsyet e skualifikimit ka ngritur pretendimet si më poshtë vijon:

III.1. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e veçantë: (2.1.2) “Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autodeklaratë që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekti prokurimi është i certifikuar konform standarteve të cilësisë ISO 9001:2015/ ose/ ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë“ ose ISO 13485: 2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtar akredituese, të njohur nga Republika e Shqipërisë”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK ploteson kriterin e vecante te kualifikimit (2.1.2).
2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK ploteson kriterin e vecante te kualifikimit (2.1.2).

Për sa me sipër, KSHA arsyeton se pretendim i operatorit ekonomik “Farma Net Albania” Sh.p.k nuk qëndron.

III.2. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretndon se Opratorët Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotesojnë kriterin e vecantë (2.1.3) “Kërkohet Autodeklaratë për materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EEC /ose ekuivalent/ (sipas aplikimit të vlefshmërisë), bashkëlidhur me kopjet e çertifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti), sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, ose çertifikim FDA. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK ploteson kriterin e vecante te kualifikimit (2,1,3).
2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK ploteson kriterin e vecante te kualifikimit (2,1,3).

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK nuk qëndron.

III.3. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë Aquarius Medical dhe CFO Pharma nuk plotësojnë në kriterin e veçantë: (2.3.2) “Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga firma prodhuese ose distributori zyrtar i

autorizuar nga prodhuesi, për tregtimin e materialeve mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar dhe origjinal ose fotokopje të noterizuara.”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK ploteson kriterin e vecante te kualifikimit (2.3.2).
2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK ploteson kriterin e vecante te kualifikimit (2.3.2).

Per sa me sipër, KSHA arsyetoi se preiendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK nuk qëndron.

III.4. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 1 SET terapie intensive Oksigjen i lengshem (litra).

Nr.	Artikulli	Specifiki me	Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)
1	SET terapie intensive Oksigjen i lengshem (litra)	Set per oksigjen terapi me mekanizem mbylles 25E dhe rregullat or per rrjedhje te vazhduar + maske Inh; Bombul alumini 3	OE nuk ka paraqitur certificate ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit te cilesise” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit te Cilesise per Pajisjet Mjekesore”, te prodhuesit ku objekti/qellimi i certifikimit te mbuloje prodhimin e pajisjeve pjese e ketij seti - nuk ploteson piken 2.1.2; OE nuk ka paraqitur certificate CE per rregullatorin per rrjedhje te vazhduar (klase II) dhe certificate ekuivalente (sipas aplikimit te vlefshmerise) per cilindrin e oksigjenit qe klasifikohet ne kategori tjeter (jo medical device) sipas dispozitave te direktives 2010/35EU dhe marreshjes ADR 2021 - nuk ploteson piken 2.1.3; OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit, ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollesishme ashtu sic kerkohen nga AK - nuk ploteson piken 2.3.3

		liter -5kg, 200 bar	
--	--	------------------------	--

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, te dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikullin numër 1, konstaton se:

- 1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, ne katalogun e dorezuar ne SPE, per artikullin nr.1, nuk ka të specifikuar mekanizmin e mbylljes, rregullatorin e rrjedhjes, bombulen prej alumini dhe peshen liter/kilogram te tij.*
- 2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK ne katalogun e dorezuar ne SPE, per artikullin nr. 1, nuk ploteson specifikat e DST (3.2 liter/5 kilogram).*

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK qëndron.

III.5. *Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 2 Sisteme infuzioni.*

<i>Nr.</i>	<i>Artikulli</i>	<i>Specifikime</i>	<i>Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)</i>
2	Sisteme infuzion i	<i>Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e pershtatshme si per shishet edhe per qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age ,</i>	<i>OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollësishme te artikullit, ashtu sic kerkohen nga AK - nuk ploteson piken 2.3.3</i>

	<p><i>luer luck + bashkuese e gomuar ne forme "Y" ose "flashball" , me PP floë rregullator , 20 pika / 1ml , e paketuar me qese te sterilizuar .</i></p>
--	--

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pas shqyrtimit te dokumentacionit te Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik Farma Net Albania SHPK, për artikullin numër 2, konstaton se:

- 1. Operatori ekonomik Aquarius Medical, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 2, mungojnë specifikimet në katalog.*

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik Farma Net Albania SHPK qëndron.

- 2. Operatori ekonomik CFO Pharma në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr,2, ka specifikimet e kërkuara në DST.*

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik Farma Net Albania SHPK nuk qëndron.

III.6. *Operatoi-i Ekonomik “FarmaNet Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertoher, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron,të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 9 Ankeplast 4 cm x 5 m.*

<i>Nr.</i>	<i>Artikulli</i>	<i>Specifikime</i>	<i>Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)</i>
------------	------------------	--------------------	--

9	Ankepl ast 4 cm x 5 m	Cope 100% pambuk, ngjites me shterese absorbuese ne mes	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollesishme/permasat ashtu sic kerkohen nga AK - nuk ploteson piken 2.3.3
---	--------------------------------	---	--

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik Farma Net Albania SHPK, për artikullin numër 9, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik Aquarius Medical ne katalogun e dorëzuar ne SPE, per artikullin nr..9, eshte e specifikuar perberja, por jo permasat.
2. Operatorin Ekonomik CFO Pharma, ne katalogun e dorezuar ne SPE, per artikullin nr.9, eshte e specifikuar perberja, por jo permasat.

III.7. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecante të, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron,të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 10 Garze 91 cm x 100 m.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)
10	Garze 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollesishme/permasat ashtu sic kerkohen nga AK - nuk ploteson piken 2.3.3

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikullin numër 10, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” ne katalogun e dorezuar ne SPE, per artikullin nr. 10, eshte e specifikuar perberja, por jo permasat,

Per sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik Farma Net Albania SHPK qëndron.

2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma”, në katalogun e dorëzuar në SPE për artikullin nr. 10, ka specifikimet e kërkuara në DST.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK nuk qëndron.

III.8. Opetatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 11 Leukoplast 2,5 cm x 5 m”.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara për skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve për skualifikim për OE Egian Med)
11	Leukoplast 2,5cm x 5m	Cope 100% pambuk, ngjites me permbajtje oksid zingu	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat të prodhuesit ku shfaqen dhe janë të markuara të gjitha specifikimet e hollesishme/permasat ashtu sic kerkohen nga AK - nuk ploteson piken 2.3.3

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK për artikullin numër 11, konstaton se:

1. Operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr 11, është e. specifikuar përberja, por jo permasat,

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i operatorit ekonomik “Farma Net Albania” SHPK qëndron.

2. Operatori ekonomik, “CFO Pharma” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE për artikullin nr.11, ka specifikimet e kërkuara në DST,

Për sa më sipër, KSHA arsyetoi se pretendimi i operatorit ekonomik “Farma Net Albania” SHPK nuk qëndron.

III.9. Operatori ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se operatorët ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë,

(2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 13 Bende 7 cm x 4 m.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara për skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve për skualifikim për OE Egian Med)
13	Bende 7cm x 4m	100% pambuk absorbent, dendësia 24 x 20	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat të prodhuesit ku shfaqen dhe janë të markuara të gjitha specifikimet e hollesishme/permasat ashtu sic kerkohen nga AK - nuk ploteson pikën 2.3.3

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikullin nr numër 13, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr.13, është e specifikuar përberja, por jo permasat.
2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPA, për artikullin nr.13, është e specifikuar përberja, por jo permasat.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit ekonomik “Farma Net Albania” SHPK qëndron.

III.10. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 14 Bende adesive 10 cm x 15 m.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara për skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve për skualifikim për OE Egian Med)

14	Bende adesive 10 cm x 15 m	Cope e pathurur poroze, elastike. Ana ngjitese e mbrojtur me leter te shqiteshme	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet/permasat ashtu sic kerkohen nga AK, madje per kete artikull mund te jete ofertuar bende elastike adevive, qe eshte produkt per perdorim komplet tjeter nga artikullin ne fjale (dicka qe ndodh shpesh ne oferta edhe ne tregun e hapur, per kete artikull) - nuk ploteson piken 2.3.3
----	-------------------------------------	---	--

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikullin numër 14, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 14, është e specifikuar përbërja, por jo përmasat,
2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr.14, është e specifikuar përbërja, por jo përmasat.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK qëndron.

III.11. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” dhe “CFO Pharma” nuk plotësojnë kriterin e vecante, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 15 Bende 10 cm x 10 m.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)
15	Bende 10 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollesishme /permasat ashtu sic kerkohen nga AK - nuk ploteson piken 2.3.3

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikullin numër 15, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 15, është e specifikuar përbërja, por jo përmasat,
2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr.15, është e specifikuar përbërja, por jo përmasat.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK qëndron.

III.12. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotesojne kriterin e vecante, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron,të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 16 Sete te medhej te Ndhimes se shpejte.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)
16	Sete te medhej te Ndhimes se shpejte	Gershere, forcept, garze adezive,garze standarte,bandazh mbajttese, plastera, garza per plage, garza me gel,piceta pastrimi per plage,doreza, mbulese emergjence.	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollesishme / te gjithe artikujt qe duhet te kete seti I ndihmes se shpejte - nuk ploteson piken 2.3.3

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik Farma Net Albania SHPK, për artikullin numër 16, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 16, ka specifikimet e kerkuara ne DST.

2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 16, ka specifikimet e kerkuara ne DST.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK nuk qëndron.

III.13. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron,të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 17 Sete te vegjel te Ndhimes se shpejte.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)
17	Sete te vegjel Ndhimes se shpejte	Gershere, garze adezive, garze standarte,bandazh mbajtese, plastera, garza per plage,piceta pastrimi per plage, doreza.	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollesishme/ te gjithe artikujt qe duhet te kete seti I ndihmes se shpejte - nuk ploteson piken 2.3.3

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikullin numër 17, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 17, ka specifikimet e kerkuara ne DST.

2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 17, ka specifikimet e kerkuara ne DST.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK nuk qëndron.

III.14. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e

vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 18 Etyl Chloride spray.

Nr.	Artikulli	Specifiki me	Arsyet e pretenduara për skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve për skualifikim për OE Egian Med)
18	Etyl Chloride spray	Flakon x 100 ml	<p>Kemi bindje se të tre keta OE për artikullin Ethyl chloride, kanë ofertuar një produkt alternativ të etil kloridit – kjo sepse, edhe në tregun e hapur, për qëllime të ngjashme përdorimi tregtohen/qarkullojnë të tilla produkte alternative që njihen gjerësisht me terma ICE spray, Freeze spray etj... Për këtë marrim shkas edhe nga arsyeja e skualifikimit të OE Egian Med, e publikuar në njoftimin e fituesit, ku KVO ka cilesuar: për artikullin me numer rendor 18 është markuar spray ftohes 150 ml, ndërkohë në SPE është kërkuar spray ftohes 100 ml.</p> <p>Në fakt në DST, është kërkuar Ethyl Chloride, flakon 100 ml dhe JO spray ftohes. Të gjithë spray ftohes që qarkullojnë (ICE spray, Freezer etj...) janë alternativa të Ethyl Chloride, i cili në fakt klasifikohet si anestetik lokal.</p> <p>Spray të tjera ftohes, jo domosdoshmërisht kanë në përbërje të tyre substancën Etil klorid.</p> <p>Spray ftohes, një lloj spray aerosol, përmban një gaz të lehtë, që përdoret për të ftohur me shpejtësi sipërfaqe të ndryshme dhe gjëra të zbatim si në mjekësi ashtu dhe në industri. Substancat (gaz i lehtë, apo gaz i kompresuar) që ky spray mund të përmbajë, dallojnë nga njëra tjetra sepse prodhojnë temperatura ftohese të ndryshme (në varesi të aplikimit)</p> <p>Keto substanca mund të jenë tetrafluoroetan, nitrogeni i lehtë, dimetil eter, etil klorid (kloroetan), ose gaz petroleum i lehtë, përfaqësojnë propanin dhe butanin.</p> <p>Mendojmë se AK ka kërkuar qëllimisht spray me përmbajtje Etil-klorid (dhe jo thjesht një spray ftohes me përmbajtje të një gazi/substance tjetër) për shkak të vetive fizike të tij, gjëra që përdorimeve/perfitimeve/rezultateve që sjell përdorimi i Etil-kloridit (vecanërisht në praktiken e përditshme të kujdesit shëndetësor paqësor).</p> <p>Pra, përse me lart, ofertat e këtyre OE nuk plotësojnë pikën</p>

			<p>2.3.3</p> <p><i>Gjithashtu, bazuar ne njohurite qe kemi produkti Ethyl Chloride spray 100 ml etj...prodhohet nga nje numer teper i kufizuar kompanish prodhuese: Dr. Georg Friedrich Henning Chemische Fabrik Eälldorf GmbH – Gjermani (prodhues me te cilin ne kemi marredhenie ekskluzive distribucioni per territorin e Shqiperise); Eäalter Ritter GmbH+Co.KG – Gjermani dhe Gebauer Company – SHBA. Duke qene keshtu, eshte teper e veshtire qe OE te kene autorizime direkte nga keto prodhues te lartpermendur; gjithashtu mendojme qe edhe nese ata kane ofertuar Ethyl Chloride spray 100ml, bazuar ne ndonje blerje/marredhenie te rastesishme nga distributore te tjere te huaj, eshte e pamundur qe te kene vertetuar lidhjen e distributoreve te autorizuar me kompanite prodhuese.</i></p> <p><i>Pra, ofertat e ketyre OE nuk plotesojne piken 2.3.2.</i></p>
--	--	--	--

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikullin numër 18, konstaton se:

- 1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 18, nuk ka specifikimet e përbërjes (etyl chloride) dhe mililitrat e flakonit (100 ml).,*
- 2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr.18, ka specifikuar mililitrat e flakonit, por nuk ka specifikuar perberjen (etyl chloride).*

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK qëndron.

III.15. *Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron,të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 20 Aparat aerosolthe rapi.*

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)
20	Aparat aerosolt herapi	Pres max. 2 bar; rrjedhja max. e ajrit 10 liter/min	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollesishme, ashtu sic kerkohen nga AK - nuk ploteson piken 2.3.3

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikullin numër 20, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 20, ploteson specifikien e shpejtesise se rrjedhjes se ajrit (litër/minutë), por nuk plotëson specifikën e presionit maksimal.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK qëndron.

2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr.20, ka specifikimet e kerkuara ne DST.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK nuk qëndron.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Farma Net Albania” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimet teknike” të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektornike përcaktohet si më poshtë:

Loti 2 “Blerje materiale mjekimi për qendrat shëndetësore që mbulojnë me shërbim zonat turistike verore gjatë sezonit të verës dhe qendrat shëndetësore që bllokohen gjatë sezonit të dimrit, për një periudhë 12 mujore”

Specifikimet Teknike:

Nr.	Artikulli	Specifikime	Njësia
1	SET terapie intensive Oksigjen i lëngshëm (litra)	Set për oksigjen terapi me mekanizëm mbyllës 25E dhe rregullator për rrjedhje të vazhduar+ maske Inh	Bombul alumini 3 litër -5kg ,200 bar
2	Sisteme infuzioni	Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e përshtatshme si për shishet edhe për qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age , luer lock + bashkuese e gomuar në formë "Y" ose "flashball" , me PP floë rregullator , 20 pika / 1ml , e paketuar me qese të sterilizuara .	Copë
3	Shiringa 10cc	Shiringe një përdorimshe sterile 10 cc, me Age 21 G, me 3 (tre) pjesë	Copë
4	Shiringa 5cc	Shiringe një përdorimshe sterile 5 cc, me Age 22 G, 3 (tre) pjesë	Copë
5	Shiringa 2cc	Shiringe një përdorimshe sterile 2 cc, me Age 23 G, 3 (tre) pjesë	Copë
6	Penj për qepje plagësh	Silk -USP 2-0, Gjatësia fije 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-35 me age 1/2 rrethore	Copë
7	Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit)	Doreza kirurgjikale me puder, latex natyral, paketuar në zarfe letre të sterilizuara me rreze Gama ose gaz Etilen sipas normativave EN; madhësia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5	Palë
8	Doreza jo sterile	Doreza egzaminimi me ose pa puder ,latex natyral, paketuar në kuti x 100 Copë (Nr. S/M/L)	Copë
9	Ankeplast 4 cm x 5 m	Copë 100% pambuk, ngjites me shterese absorbuese në mes	Pako
10	Garze 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendësia 24x20	meter linear

11	Leukoplast 2,5cm x 5m	Copë 100% pambuk, ngjites me permbajtje oksid zingu	Copë
12	Pambuk kirurgjikal	100% pambuk hidrofil, pakete 100 g	Copë
13	Bende 7cm x 4m	100% pambuk absorbent, dendesia 24 x 20	Copë
14	Bende adesive 10 cm x 15 m	Copë e pathurur poroze, elastike. Ana ngjites e mbrojtur me leter te shqiteshme	Copë
15	Bende 10 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
16	Sete te medhej te Ndhimes se shpejte	Gershere, forcept, garze adezive,garze standarte,bandazh mbajtese, plastera, garza per plage, garza me gel,piceta pastrimi per plage,doreza, mbulesa emergjence.	Copë
17	Sete te vegjel Ndhimes se shpejte	Gershere, garze adezive, garze standarte,bandazh mbajtese, plastera, garza per plage,piceta pastrimi per plage,doreza.	Copë
18	Etyl Chloride spray	Flakon x 100 ml	Flakon
19	Chlorhexidine gluconate	4% chlorexidine gluconate; Antiseptik me efekt baktericid, fungicid, antiviral . Për desinfektimin e duarve, i gatshem për ta përdorur	Litra
20	Aparat aerosoltherapi	Pres max. 2 bar; rrjedhja max. e ajrit 10 liter/min	Copë
21	Peshore per te rritur	Minimalisht 120 kg; gabimi nga 50-100 kg jo më shumë se 1,5 njesi	Copë
22	Aparat Glicemie	Set me Aparat mates dhe shpues automatik.	Copë
23	Stripse Glicemie	Stripse testi ne pako x 50	Copë
24	Spatula druri	Copë	Copë
25	Aparat tensioni	me manometer	Copë
26	Termometer	me zhive	Copë
27	Alcohol	Alkol etilik per perdorim te jashtem, perqendrimi 95%/96 %	Litra

Për materialet e mjekimit:

- *Materialet e mjekimit datën e skadencës (minimumi 1 vit nga data e lëvrimin) duhet ta kenë të shënuar në ambalazhe (kutitë).*
- *Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.*
- *Ofertuesi duhet të permbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësore detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në tabelat në DST për këtë procedurë prokurimi.*

III.1.2. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.3 “Kapaciteti Teknik” Loti II të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektornike përcaktohet si më poshtë:

Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofrohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

III.1.3. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 3095/32 prot, datë 06.12.2022, protokolluar me tonën me nr. 2666/3 prot datë 07.12.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës si më poshtë vijon:

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK në ankesën e tij, bazuar në arsyet e skualifikimit ka ngritur pretendimet si më poshtë vijon:

III.1. *Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e veçantë: (2.1.2) “Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autodeklaratë që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekti prokurimi është i certifikuar konform standarteve të cilësisë ISO 9001:2015/ ose/ ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë“ ose ISO 13485: 2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtar akredituese, të njohur nga Republika e Shqipërisë”.*

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, konstaton se:

- 1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK ploteson kriterin e vecante te kualifikimit (2.1.2).*
- 2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK ploteson kriterin e vecante te kualifikimit (2.1.2).*

Për sa me sipër, KSHA arsyeton se pretendim i operatorit ekonomik “Farma Net Albania” Sh.p.k nuk qëndron.

III.2. *Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotesojnë kriterin e vecantë (2.1.3) “Kërkohet Autodeklaratë për materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EEC /ose ekuivalent/ (sipas aplikimit të vlefshmërisë), bashkëlidhur me kopjet e çertifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti), sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, ose çertififikim FDA. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit”.*

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, konstaton se:

- 1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK ploteson kriterin e vecante te kualifikimit (2,1,3).*
- 2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK ploteson kriterin e vecante te kualifikimit (2,1,3).*

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK nuk qëndron.

III.3. *Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë Aquarius Medical dhe CFO Pharma nuk plotësojnë në kriterin e veçantë: (2.3.2) “Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga firma prodhuese ose distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi, për tregtimin e materialeve mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar dhe origjinal ose fotokopje të noterizuara.”.*

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, konstaton se:

- 1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK ploteson kriterin e vecante te kualifikimit (2.3.2).*

2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK ploteson kriterin e vecante te kualifikimit (2.3.2).

Per sa me siper, KSHA arsyetoi se preiendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK nuk qëndron.

III.4. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertoher, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 1 SET terapie intensive Oksigjen i lengshem (litra).

Nr.	Artikulli	Specifiki me	Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)
1	SET terapie intensive Oksigjen i lengshem (litra)	Set per oksigjen terapi me mekanizem mbylles 25E dhe rregullat or per rrjedhje te vazhduar + maske Inh; Bombul alumini 3 liter -5kg, 200 bar	OE nuk ka paraqitur certificate ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit te cilesise” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit te Cilesise per Pajisjet Mjekesore”, te prodhuesit ku objekti/qellimi i certifikimit te mbuloje prodhimin e pajisjeve pjese e ketij seti - nuk ploteson piken 2.1.2; OE nuk ka paraqitur certificate CE per rregullatorin per rrjedhje te vazhduar (klase II) dhe certificate ekuivalente (sipas aplikimit te vlefshmerise) per cilindrin e oksigjenit qe klasifikohet ne kategori tjeter (jo medical device) sipas dispozitave te direktives 2010/35EU dhe marreveshjes ADR 2021 - nuk ploteson piken 2.1.3; OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit, ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollesishme ashtu sic kerkohen nga AK - nuk ploteson piken 2.3.3

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, te dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikullin numër 1, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, ne katalogun e dorezuar ne SPE, per artikullin nr.1, nuk ka të specifikuar mekanizmin e mbylljes, rregullatorin e rrjedhjes, bombulen prej alumini dhe peshen liter/kilogram te tij.
2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK ne katalogun e dorezuar ne SPE, per artikullin nr. 1, nuk ploteson specifikat e DST (3.2 liter/5 kilogram).

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK qëndron.

III.5. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertoher, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 2 Sisteme infuzioni.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)
2	Sisteme infuzioni	Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e pershtatshme si per shishet edhe per qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age , luer lock + bashkuese e gomuar ne forme "Y" ose "flashball" , me PP floë rregullator , 20 pika / 1ml , e paketuar me qese te sterilizuar .	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollesishme te artikullit, ashtu sic kerkohen nga AK - nuk ploteson piken 2.3.3

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik Farma Net Albania SHPK, për artikullin numër 2, konstaton se:

1. Operatori ekonomik Aquarius Medical, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 2, mungojnë specifikimet në katalog.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik Farma Net Albania SHPK qëndron.

2. Operatori ekonomik CFO Pharma në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr.2, ka specifikimet e kërkuara në DST.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik Farma Net Albania SHPK nuk qëndron.

III.6. Operatori-i Ekonomik “FarmaNet Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 9 Ankeplast 4 cm x 5 m.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara për skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve për skualifikim për OE Egian Med)
-----	-----------	-------------	---

9	Ankeplast 4 cm x 5 m	Cope 100% pambuk, ngjites me shterese absorbuese në mes	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat të prodhuesit ku shfaqen dhe janë të markuara të gjitha specifikimet e hollesishme/permasat ashtu siç kerkohen nga AK - nuk ploteson piken 2.3.3
---	----------------------	---	--

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik Farma Net Albania SHPK, për artikullin numër 9, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik Aquarius Medical në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr.9, është specifikuar përberja, por jo përmasat.

2. Operatorin Ekonomik CFO Pharma, ne katalogun e dorezuar ne SPE, per artikullin nr.9, eshte e specifikuar perberja, por jo permasat.

III.7. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecante të, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron,të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 10 Garze 91 cm x 100 m.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)
10	Garze 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollesishme/permasat ashtu sic kerkohen nga AK - nuk ploteson piken 2.3.3

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikullin numër 10, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” ne katalogun e dorezuar ne SPE, per artikullin nr. 10, eshte e specifikuar perberja, por jo permasat,

Per sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik Farma Net Albania SHPK qëndron.

2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma”, në katalogun e dorëzuar në SPE për artikullin nr. 10, ka specifikimet e kërkuara ne DST.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK nuk qëndron.

III.8. Opetatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në

katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 11 Leukoplast 2,5 cm x 5 m”.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara për skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve për skualifikim për OE Egian Med)
11	Leukoplast 2,5cm x 5m	Cope 100% pambuk, ngjites me permbajtje oksid zingu	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat të prodhuesit ku shfaqen dhe janë të markuara të gjitha specifikimet e hollesishme/permasat ashtu sic kerkohen nga AK - nuk ploteson piken 2.3.3

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK për artikullin numër 11, konstaton se:

1. Operator i ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr 11, është e specifikuar përberja, por jo permasat,

Për sa me sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i operatorit ekonomik “Farma Net Albania” SHPK qëndron.

2. Operatori ekonomik, “CFO Pharma” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE për artikullin nr.11, ka specifikimet e kërkuara në DST,

Për sa më sipër, KSHA arsyetoi se pretendimi i operatorit ekonomik “Farma Net Albania” SHPK nuk qëndron.

III.9. Operatori ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se operatorët ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 13 Bende 7 cm x 4 m.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara për skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve për skualifikim për OE Egian Med)
-----	-----------	-------------	---

13	Bende 7cm x 4m	100% pambuk absorbent, dendesia 24 x 20	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollesishme/permasat ashtu sic kerkohen nga AK - nuk ploteson piken 2.3.3
----	----------------------	---	--

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikulli nr numër 13, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, ne katalogun e dorezuar ne SPE, per artikullin nr.13, eshte e specifikuar perberja, por jo permasat.
2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK, ne katalogun e dorezuar ne SPA, per artikullin nr.13, eshte e specifikuar perberja, por jo permasat.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit ekonomik “Farma Net Albania” SHPK qëndron.

III.10. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 14 Bende adesive 10 cm x 15 m.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)
14	Bende adesive 10 cm x 15 m	Cope e pathurur poroze, elastike. Ana ngjitese e mbrojtur me leter te shqiteshme	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet/permasat ashtu sic kerkohen nga AK, madje per kete artikull mund te jete ofertuar bende elastike adezive, qe eshte produkt per perdorim komplet tjeter nga artikullin ne fjale (dicka qe ndodh shpesh ne oferta edhe ne tregun e hapur, per kete artikull) - nuk ploteson piken 2.3.3

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikullin numër 14, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 14, është e specifikuar përbërja, por jo përmasat,
2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr.14, është e specifikuar përbërja, por jo përmasat.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK qëndron.

III.11. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” dhe “CFO Pharma” nuk plotësojnë kriterin e vecante, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron,të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 15 Bende 10 cm x 10 m.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)
15	Bende 10 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollesishme /permasat ashtu sic kerkohen nga AK - nuk ploteson piken 2.3.3

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikullin numër 15, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 15, është e specifikuar përbërja, por jo përmasat,
2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr.15, është e specifikuar përbërja, por jo përmasat.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK qëndron.

III.12. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotesojne kriterin e vecante, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe

specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 16 Sete te medhej te Ndhimes se shpejte.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)
16	Sete te medhej te Ndhimes se shpejte	Gershere, forcept, garze adezive, garze standarte, bandazh mbajtese, plastera, garza per plage, garza me gel, piceta pastrimi per plage, doreza, mbulese emergjence.	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollesishme / te gjitha artikujt qe duhet te kete seti I ndihmes se shpejte - nuk ploteson piken 2.3.3

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik Farma Net Albania SHPK, për artikullin numër 16, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 16, ka specifikimet e kerkuara ne DST.
2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 16, ka specifikimet e kerkuara ne DST.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK nuk qëndron.

III.13. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 17 Sete te vegjel te Ndhimes se shpejte.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)
17	Sete te vegjel Ndhimes se shpejte	Gershere, garze adezive, garze standarte, bandazh mbajtese, plastera, garza per plage, piceta pastrimi per plage, doreza.	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollesishme/ te gjitha artikujt qe duhet te kete seti I ndihmes se shpejte - nuk ploteson piken 2.3.3

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikullin numër 17, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 17, ka specifikimet e kerkuara ne DST.
2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 17, ka specifikimet e kerkuara ne DST.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK nuk qëndron.

III.14. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 18 Etyl Chloride spray.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)
-----	-----------	-------------	---

18	Etyl Chloride spray	Flakon x 100 ml	<p><i>Kemi bindje se te tre keta OE per artikullin Ethyl chloride, kane ofertuar nje produkt alternative te etil kloridit – kjo sepse, edhe ne tregun e hapur, per qellime te ngjashme perdorimi tregtohen/qarkullojne te tilla produkte alternative qe njihen gjeresisht me terma ICE spray, Freeze spray etj... Per kete marrim shkas edhe nga arsyeja e skualifikimit te OE Egian Med, e publikuar ne njoftimin e fituesit, ku KVO ka cilesuar: per artikullin me numer rendor 18 eshte markuar spraj ftohes 150 ml, nderkohe ne SPE eshte kerkuar spraj ftohes 100 ml.</i></p> <p><i>Ne fakt ne DST, eshte kerkuar Ethyl Chloride, flakon 100 ml dhe JO spraj ftohes. Te gjitha spraj ftohes qe qarkullojne (ICE spray, Freezer etj...) jane alternativa te Ethyl Chloride, i cili ne fakt klasifikohet si anestetik lokal.</i></p> <p><i>Spraj te tjere ftohes, jo domosdoshmerisht kane ne perberje te tyre substancen Etil klorid.</i></p> <p><i>Spraj ftohes, nje lloj spraj aerosol, permban nje gaz te lengshem, qe perdoret per te ftohur me shpejtesi siperfaqe te ndryshme dhe gjen zbatim si ne mjekesi ashtu dhe ne industri. Substancat (gaz i lengshem, apo gaz i kompresuar) qe ky spraj mund te permbaje, dallojne nga njera tjetra sepse prodhojne temperatura ftohese te ndryshme (ne varesi te aplikimit)</i></p> <p><i>Keto substanca mund te jene tetrafluoroetan, nitrogen i lengshem, dimetil eter, etil klorid (kloroetan), ose gaz petroleum i lengshem, perfshi propanin dhe butanin.</i></p> <p><i>Mendojme se AK ka kerkuar qellimisht spraj me permbajtje Etil-kloridi (dhe jo thjesht nje spraj ftohes me permbajtje te nje gazi/substance tjeter) per shkak te vetive fizike te tij, games se gjere te perdorimeve/perfitimeve/rezultateve qe sjell perdorimi i Etil-kloridit (vecanerisht ne praktiken e perditshme te kujdesit shendetesor paresor).</i></p> <p><i>Pra, persa me lart, ofertat e ketyre OE nuk plotesojne piken 2.3.3</i></p> <p><i>Gjithashtu, bazuar ne njohurite qe kemi produkti Ethyl Chloride spray 100 ml etj...prodhohet nga nje numer teper i kufizuar kompanish prodhuese: Dr. Georg Friedrich Henning Chemische Fabrik Eälldorf GmbH – Gjermani (prodhues me te cilin ne kemi marredhenie ekskluzive distribucioni per territorin e Shqiperise); Eäalter Ritter GmbH+Co.KG – Gjermani dhe Gebauer Company – SHBA. Duke qene keshtu, eshte teper e veshtire qe OE te kene</i></p>
----	---------------------	-----------------	---

		<p>autorizime direkte nga keto prodhues te lartpermendur; gjithashtu mendojme qe edhe nese ata kane ofertuar Ethyl Chloride spray 100ml, bazuar ne ndonje blerje/marredhenie te rastesishme nga distributore te tjere te huaj, eshte e pamundur qe te kene vertetuar lidhjen e distributoreve te autorizuar me kompanite prodhuese.</p> <p>Pra, ofertat e ketyre OE nuk plotesojne piken 2.3.2.</p>
--	--	---

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikullin numër 18, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 18, nuk ka specifikimet e përbërjes (etyl chloride) dhe mililitrat e flakonit (100 ml),
2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr.18, ka specifikuar mililitrat e flakonit, por nuk ka specifikuar perberjen (etyl chloride).

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK qëndron.

III.15. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK pretendon se Operatorët Ekonomikë “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK nuk plotësojnë kriterin e vecantë, (2.3.3) “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për artikullin nr. 20 Aparat aerosolthe rapi.

Nr.	Artikulli	Specifikime	Arsyet e pretenduara per skualifikimin e OE Aquarius Medical; CFO Pharma; (si dhe shtimin e arsyeve per skualifikim per OE Egian Med)
-----	-----------	-------------	---

20	Aparat aerosolt herapi	Pres max. 2 bar; rrjedhja max. e ajrit 10 liter/min	OE nuk ka paraqitur katalogun adekuat te prodhuesit ku shfaqen dhe jane te markuara te gjitha specifikimet e hollesishme, ashtu sic kerkohen nga AK - nuk ploteson piken 2.3.3
----	------------------------	---	--

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorëve Ekonomikë, të dorëzuar në SPE prej tyre, lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, për artikullin numër 20, konstaton se:

1. Operatori Ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. 20, ploteson specifikien e shpejtesise se rrjedhjes se ajrit (litër/minutë), por nuk plotëson specifikën e presionit maksimal.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK qëndron.

2. Operatori Ekonomik “CFO Pharma” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr.20, ka specifikimet e kerkuara ne DST.

Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi i Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” SHPK nuk qëndron.

II.1.4. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera”.

III.1.5. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.6. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Farma Net Albania” në ankesën nr 2666 prot, datë 30.11.2022, janë pranuar pjesërisht nga ana e autoritetit kontraktor Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shendetësor konkretisht me vendimin nr. 3095/31 prot, datë 05.12.2022 nga ana e autoritetit kontraktor janë pranuar pretendet në lidhje me mosplotësimin e kriterit të vecantë të kualifikimit 2.3.3 të dokumentave standarte të tederit në të cilin përcaktohet se “Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit”, konkretisht nga ana e komisionit të shqyrtimit të ankesës pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik SPE rezulton se operatori ekonomik “Aquarius Medical” në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. **1 SET terapie intensive Oksigjen i lengshem (litra)**, nuk ka të specifikuar mekanizmin e mbylljes, rregullatorin e rrjedhjes, bombulen prej alumini dhe peshen liter/kilogram të tij, ndërsa operatori ekonomik “CFO Pharma” SHPK në katalogun e dorëzuar në SPE, për artikullin nr. **1**, nuk plotëson specifikat e DST (3.2 liter/5 kilogram). Për artikullin nr. **2 Sisteme infuzioni** operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, në katalogun e dorëzuar në SPE, mungojnë specifikimet në katalog. Për artikullin nr. **9. Ankeplast 4cm x 5m**, operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK në katalogun e dorëzuar në SPE, nuk kanë të specifikuar permasat. Për artikullin nr. **10. Garze 91cm x 100m**, operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK në katalogun e dorëzuar në SPE, nuk ka të specifikuar permasat. Për artikullin nr. **11 Leukoplast 2,5cm x 5m** operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK në katalogun e dorëzuar në SPE, nuk ka të specifikuar permasat. Për artikullin nr. **13. Bende 7cm x 4m** operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK në katalogun e dorëzuar në SPE, nuk kanë të specifikuar permasat. Për artikullin nr. **14. Bende adesive 10cm x 15m** operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK në katalogun e dorëzuar në SPE, nuk kanë të specifikuar permasat. Për artikullin nr. **15. Bende 10cm x 10m** operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK dhe “CFO Pharma” SHPK në katalogun e dorëzuar në SPE, nuk kanë të specifikuar permasat. Për artikullin nr. **18. Etyl Chloride spray** operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK në katalogun e dorëzuar në SPE, nuk ka specifikimet e përbërjes (etyl chloride) dhe mililitrat e flakonit (100 ml), ndërsa operatori ekonomik “CFO Pharma”

SHPK në katalogun e dorëzuar në SPE, nuk ka specifikuar perberjen (etyl chloride). Për artikullin nr. 20. *Aparat aerosoltherapi* operatori ekonomik “*Aquarius Medical*” SHPK në katalogun e dorëzuar në SPE, nuk plotëson specifikën e presionit maksimal.

Në përfundim, sa më sipër analizuar, nga verifikimi i vendimit nr. 3095/31 prot, datë 05.12.2022 i komisionit të shqyrtimit të ankesës, si dhe përcaktimeve të bëra nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit shtojca 5 “*Formulari i Specifikimeve Teknike*”, KSHA ka konstatuar mospërmbushje të specifikimeve teknike nga ana e operatorit ekonomik “*Aquarius Medical*” SHPK për artikujt me nr. 1. *SET terapie intensive Oksigjen i lengshem (litra)*, nr. 2 *Sisteme infuzioni*, nr. 9. *Ankeplast 4cm x 5m*, nr. 10. *Garze 91cm x 100m*, nr. 11 *Leukoplast 2,5cm x 5m*, nr. 13. *Bende 7cm x 4m*, nr. 14. *Bende adesive 10cm x 15m*, nr. 15. *Bende 10cm x 10m*, nr. 18. *Etyl Chloride spray*, nr. 20. *Aparat aerosoltherapi*, ndërsa për operatorin ekonomik “*CFO Pharma*” SHPK ka konstatuar mospërmbushje të specifikimeve teknike për artikujt me nr. 1 *SET terapie intensive Oksigjen i lengshem (litra)*, nr. 9. *Ankeplast 4cm x 5m*, nr. 13. *Bende 7cm x 4m*, nr. 14. *Bende adesive 10cm x 15m*, nr. 15. *Bende 10cm x 10m*, nr. 18. *Etyl Chloride spray*. KPP nga sa më sipër konstaton se ankesa e operatorit ekonomik ankimues “*Farma Net Albania*” SHPK është pranuar pjesërisht duke arritur qëllimin e tij në këtë procedurë prokurimi duke skualifikuar operatorin ekonomik “*Aquarius Medical*” SHPK dhe “*CFO Pharma*” SHPK për mospërmbushje të specifikimeve teknike si më sipërcituar, ndaj për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes, autoriteti kontraktor duhet të rivlersojë procedurën e prokurimit objekt ankimi në zbatim të vendimit të KSHA-së nr. 3095/31 prot, datë 05.12.2022, duke skualifikuar operatorin ekonomik “*Aquarius Medical*” SHPK dhe “*CFO Pharma*” SHPK, si rrejdhojë e pranimit pjesërisht pretendimeve të ankimuesit në ankesën nr. 2666 prot, datë 30.11.2022. Në këtë kuptim KPP gjykon se qëllimi i përdorimit të instrumentit të ankimimit nga ana e operatorit ekonomik ankimues si një operator ekonomik i interesuar dhe i legjitimuar për të bërë ankesë është përmbushur si rrjedhojë e pranimit të ankesës, ndaj dhe KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes objekt ankimi në përputhje me nenin 115 pika 3 gërma “b” e ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 , pika 1 dhe 3 e nenit 115 dhe neni 118 i ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neni 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatorin ekonomik “*Farma Net Albania*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-

46319-10-18-2022, me objekt Loti 2 “Blerje materiale mjekimi për qendrat shëndetësore që mbulojnë me shërbim zonat turistike verore gjatë sezonit të verës dhe qendrat shëndetësore që bllokohen gjatë sezonit të dimrit, për një periudhë 12 mujore”, me fond limit 10,062,292 (dhjetë milion e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03-11-2022 nga autoriteti kontraktor Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shendetësor.

2. Autoriteti kontraktor të kryej rivlerësimin e procedurës në zbatim të vendimit të KSHA-së Nr. 3095/31 prot, datë 05.12.2022, dhe të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Farma Net Albania” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri